

KORRIK 2024

Nr . (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
38	4.07.2024	Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentacionit zyrtare	10.07.2024	Kthyer përgjigje me shkresë	Përfunduar	0
39	10.07.2024	Kërkese për informacion ne lidhje me: Në çfarë faze janë punimet për aeroportin turistiko-sportiv në Korçë? Sa është kostoja totale e financimit të këtij aeroporti? Çfarë punime janë kryer dhe çfarë kanë ngelur pa bërë për të përfunduar aeroporti turistiko-sportiv në Korçë? Kur pritet të përfundojë projekti? Pse nuk ka është finalizuar ende aeroporti në Korçë?	10.07.2024	Deleguar te Bashkia Korçe, pasi kërkesa ishte drejtuar Bashkisë.	Përfunduar	0

		Kush e financon këtë projekt? Cilat janë arsyet e vonesave të këtij projekti brenda afateve të bëra publike?				
40	18.07.2024	Kërkesë për informacion: një kopje (dokument) të matricës së akteve të cilat janë programuar të miratohen gjatë këtij viti.	22.07.2024	Në vijim të e-mail-it tuaj, informacionin e kërkuar e gjeni ne link-un bashkëlidhur: https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/12/28/790/b58a06cd-29ef-4634-b024-e9a0c8244baa;q=VENDIMIN%20nr.%20790,%20dat%C3%AB%2028.12.2023%20	Përfunduar	0
41	16.07.2024	Në relacionin për projekt vendimin për shpalljen "Peizazh i mbrojtur...Pishë-Poro-Nartë, Kat. V", në Kapitullin III (Për argumentimin...) thuhet se "Procesi i vlerësimit të zonës u realizua, pas grumbullimit dhe shqyrtimit të gjendjes ekzistuese të natyrës dhe biodiversitetit, analizimit dhe shqyrtimit të kufirit të zonës së mbrojtur nëpërmjet konsultimeve me komunitetet e zonave dhe aktorët e tjerë të interesuar (akademikët, shoqërinë	26.07.2024	Në përgjigje të kërkesës për informacion të gazetarit z. *****, protokolluar në AKZM me nr. 2505 prot., datë 17.07.2024, nëpërmjet të cilës kërkohet informacion në lidhje me konsultat që janë kryer me akademikë, shoqërinë civile, shoqatat mjedisore etj., në lidhje me projekt vendimin për shpalljen "Për shpalljen e territorit Pishë Poro-Nartë, peisazh i mbrojtur Ujor/Tokësor", kategoria e V", ju informojmë se: Zona e mbrojtur Peizazh i Mbrojtur "Pishë Poro – Nartë" është shpallur e tillë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 694, datë 26.10.2022 "Për Ndryshimin e statusit të ekosistemit natyror/ligatinor "Pishë Poro – Nartë" nga "Rezervat Natyror i Menaxhuar" (kategoria IV e zonave të mbrojtura) në "Peizazh i Mbrojtur" (kategoria V e zonave të mbrojtura).	Përfunduar	0

		civile, shoqatat mjedisore etj).". Ju lutem, për ç ‘konsulta bëhet fjalë, kur janë kryer etj, pra më kaloni një dokument ku të provohet kryerja e tyre (koha, vendi, pjesëmarrja, çështjet kryesore), jo shumë i gjatë.		Ky ndryshim është me përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, i ndryshuar, me parashikimin e elementëve tekniko formalë të kategorisë së peizazhit. Në dispozitat klaimtare të tij është parashikuar që “Brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Këshilli i Ministrave, Ministria përgjegjëse për zonat e mbrojtura miratojnë aktet e nevojshme për shpalljen e zonave të mbrojtura në përputhje me parashikimet e këtij ligji”. Për këtë arsye është hartuar ky projektvendim, i cili synon përputhjen me parashikimet e reja ligjore, në ligjin për zonat e mbrojtura Duke qënë se ky projektvendim synon përputhjen me parashikimet e reja ligjore dhe kemi të bëjmë vetëm me ndryshime të elementëve tekniko-formalë të saj dhe jo ndryshime në sipërfaqe, Ju sqarojmë se konsultat dhe takimet e përmendura në relacionin e projekt vendimit, janë takimet e mbajtura gjatë kohës së kryerjes së studimit të rivlerësimit të sistemit të zonave të mbrojtura të vitit 2019. Për realizimin e objektivave të këtij studimi u kryhen disa verifikime në terren, mbi 42 takime, në 12 qarqe, nga të cilat 3 ishin rajonale; një numër të konsiderueshëm diskutime me Administratat e Zonave të Mbrojtura (AdZM), Organizatat e Shoqërisë Civile (OShC), botën akademike dhe universitetet etj.		
42	19.07.2024	Kërkese për informacion ne lidhje me: Dëshiroj te di cili është kontributi i Shqipërisë ne projektin e ri-mëkëmbjes se rrëqebullit Ballkanik, cilat janë te arriturat reale	29.07.2024	Rrëqebulli (Lynx lynx), kafsha vetmitare në rajonin e Ballkanit është një specie e rrezikuar, e cila prej vitit 2017 monitorohet përmes kamerave kurth, si dhe vëzhgohet përmes gjurmëve e qimeve në ato Zona të Mbrojtura ku	Përfunduar	0

	nga ana e shtetit shqiptar dhe çfarë po mendohet te behet për bio-korridoret e kësaj specie rreptësishtë e mbrojtur. 2. A mundet te kem një liste te monumenteve te kulturës, zonave natyrore dhe çdo lloj kategorie qe gëzon mbrojtje (duke përfshire dhe atë jo-materiale) për qarkun e Dibrës.		jeton. Në rajon numërohen rreth 50 individ rrëqebujsh, nga ku 7-10 prej tyre gjenden në Shqipëri. Numri jo i lartë i rrëqebullit, maces vetmitare të Ballkanit, kërkon ruajtje optimale të biodiversiteti dhe shmangies së rreziqeve, pasi kështu ruhen balancat dhe shtohet numri i këtyre individëve në të gjithë rajonin. Rrëqebulli mbrohet, sipas “Ligjit për Mbrojtjen e Faunës së Egër”, “Ligjit për gjuetinë”, “Konventa e Bërnës”, “Direktiva Evropiane për habitatet dhe gjallesat” dhe “Konventa Ndërkombëtare për Tregtinë e Specieeve në rrezik”. Data 11 qershor e çdo viti, është dita Ndërkombëtare e Rrëqebullit, ditë në të cilën kremtohet, duke kujtuar rëndësinë e këtij individi, përmes aktiviteteve dhe nismave gjithëpërfshirëse institucionale dhe të shoqërisë civile. Në përpjekje për të ruajtur specien endemike të rrëqebullit Ballkanik, AKZM në janar të vitit 2022 shpalli si zonë të mbrojtur Parkun Natyror të Munellës, si habitat i vetëm ku riprodhohet rrëqebulli i Ballkanit në Shqipëri. Shpallja e këtij Parku Natyror është një tjetër sukses në historinë e ruajtjes së kësaj specieje; për ta mbrojtur nga kërcënimet e mundshme, si, gjuetia e paligjshme, prerja e pyjeve dhe degradimi. Rrëqebulli, vetmitari i pyjeve është evidentuar nga kamerat kurth në Pukë, Korab-Koritinik dhe Pogradec.	
--	---	--	--	--

			Me një gjatësi prej 110 cm, ai është i aftë të kërcejë në një distancë prej 10 metra, aftësi që e bën një “gjuetar” të fuqishëm në natyrë. Rrëqebulli pëlqen pyjet e lartë dhe të paarrtshme nga njeriu. Është kafshë e cila ruan me së miri territorin e tij, duke mos pranuar individë të tjerë, qoftë të së njëjtës familje. Dëshira, për të zotëruar territorin është edhe mes mashkullit e femrës, të cilët afrohen me njëri-tjetrin vetëm përgjatë periudhës së çiftimit. Mënyra e ushqimit të rrëqebullit ndryshon sipas stinës, sasisë dhe llojit të ushqimit që ai mund të sigurojë. Ushqehet me shpendë, brejtës dhe dythundrakë të vegjël si, dhia e egër dhe kaprolli. Rrëqebulli më së shumti lëviz gjatë natës dhe gjuan për ushqim kryesisht gjatë mbrëmjes. Gjatë ditës ai fle dhe fshihet në pyje, të cilët janë edhe shtëpia e tij. Një individ rrëqebulli mund të jetojë 10 deri në 15 vjet. Kjo nën specie është plotësisht e mbrojtur nga legjislacioni Shqiptar, si dhe nga Konventat ndërkombëtare. Është gjithashtu dhe pjese e Konventës se CITES e te Bernës (Aneksi II) Ndërkohe ne shkurt 2024 Maqedonia e Veriut se bashku me Shqipërinë dorëzoi aplikimin ne Konferencën e Palëve te Konventës për specie Migratore (CMS) qe u mbajnë ne Uzbekistan, për futjen e të rrëqebullit euroaziatik në Shtojcën II dhe rrëqebullit të Ballkanit (si nën specie të rrëqebullit euroaziatik) si shtesë në Shtojcën II, dhe gjithashtu dhe në Shtojcën I të Konventës për Ruajtjen e Llojeve migratore të Kafshëve të Egra (CMS), propozim qe çoi ne këtë mënyre futjen e të rrëqebullit euroaziatik në	
--	--	--	--	--

				Shtojcën II dhe rrëqebullit të Ballkanit (si nën specie të rrëqebullit euroaziatik) si shtesë në Shtojcën II, gjithashtu në Shtojcën I të Konventës për Ruajtjen e Llojeve migratore të Kafshëve të Egra (CMS).		
43	30.07.2024	Kërkesë për informacion në lidhje me: 1. Cila është struktura përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e “Konventës për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër (CITES)” në Shqipëri? 2. Si organizohet kjo strukturë? 3. A janë të aksesueshme për publikun shqipfolës përmes data bazave në internet të dhënat e CITES për Shqipërinë? 4. Na vendosni në dispozicion të dhënat e regjistrimit të CITES në Shqipëri për 10 vitet e fundit;		Në proces		

		4.1 Na informoni në detaje për secilin prej rasteve të regjistruara, ashtu siç ju i posedoni të dhënat teknike; 5. Sa raste të paligjshme ka evidentuar Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet e saj të varësisë në vendin tonë në 10 vitet e fundit, të mbajtjes apo të trafikimit të individëve të faunës së egër për qëllime të posedimit personal apo për qëllime tregtimi të individëve të llojeve të mbrojtura apo pjesë e CITES? 5.1 Sa prej këtyre rasteve lidhen me individët "luanë" dhe tigra"? 6. Sa raste të paligjshme ka evidentuar Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet e saj të varësisë në vendin tonë në 10 vitet e fundit, të mbajtjes apo të trafikimit të individëve të faunës së egër, me qëllim tregtimin, ekspozimin dhe ofertimin për shitje ose bërjen të ditur për publikun të individëve				
--	--	--	--	--	--	--

		të llojeve të mbrojtura apo pjesë e CITES? 6.1 Sa prej këtyre rasteve lidhen me individët "luanë" dhe tigra"? 7. A ka pasur raste kur qytetarët apo Organizatat Jofitimprurëse kanë kërkuar mbështetje për këto raste, apo që i kanë referuar si informacione? Nëse po, si është vepruar nga ana juaj? 8. A ka pasur bashkëpunime ndërkombëtare në kuadër të kësaj veprimtarie të paligjshme? Nëse po, na informoni më në detaje për këto bashkëpunime. 9. A ka MTM struktura apo ambiente, të specializuara për kapjen, trajtimin dhe mbajtjen e individëve të faunës së egër që konfiskohen/sekuestrohen në ambiente private?				
--	--	--	--	--	--	--

Shënim:

Regjistri përditësohet çdo muaj.

- (1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.
- (2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.
- (3) Identifikohet lloji i kërkesës.
- (4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.

(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)

- (5) Ndhmon kërkesin për të njohur ecurinë e procesit.
- (6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.